

V E N D I M

Nr.288, datë 18.6.1999

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS SË ZHVILLIMIT
TË SEKTORIT TË TELEKOMUNIKACIONIT
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikave 1 dhe 2 të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë
se Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të sektorit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të bashkëpunojë me Entin Rregullator të Telekomunikacionit për përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore e nënligjore, për licencimin e operatorëve në fushën e telekomunikacionit.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko